

VENDIM
Nr.294, datë 22.12.2004

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT
“ASPARAG”
SUBJEKTIT: Z. BARDHYL TOSKU

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, si dhe të vendimit nr.287, datë 29.10.2004 “Për shqyrtimin e dokumentacionit për marrjen e licencës së subjektit televiziv kabllor TV Asparag” të Këshillit Kombëtar të Radios dhe të Televizionit, ky i fundit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Bardhyl Tosku, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Rrogozhinës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj